



Në bazë të nenit 103 dhe 149 të Ligjit për arsim të lartë të RMV-së („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 82/18), Statutit të Universitetit të Tetovës, Rregullores për kushtet, kriteret dhe rregullat për regjistrimin e studentëve në studimet e ciklit të dytë në Universitetin e Tetovës, Vendimit nga mbledhja e Këshillit të Rektoratit të datës 01.04.2026 me nr. 02-605/1, si dhe në bazë të Vendimit të Qeverisë së RMV-së me numër 57-4993/8 të datës 14.07.2026 („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 160/26), Universiteti i Tetovës shpall:

K O N K U R S

për regjistrimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve në Universitetin e Tetovës, në vitin akademik 2026/27

I. Numri i studentëve:

Universiteti i Tetovës në studimet e ciklit të dytë, në vitin akademik 2026/27, do ta regjistrojë numrin e studentëve si në vijim:

FAKULTETI FILOLOGJIK	ECTS**	Thirrja shkencore	Euro/Semestër*	Numri i studentëve
Gjuhë Angleze	60	Magjistër i gjuhës angleze	750	10
Gjuhë Angleze	120	Magjistër i gjuhës angleze	500	10
Gjuhë Frënge	60	Magjistër i gjuhës frënge	750	5
Gjuhë Gjermane	60	Magjistër i gjuhës gjermane	750	10
Gjuhë Maqedonase	60	Magjistër i gjuhës maqedonase	750	5
Gjuhë Shqipe	60	Magjistër i gjuhës shqipe	750	10
Letërsi Angleze	60	Magjistër i letërsisë angleze	750	10
Letërsi Angleze	120	Magjistër i letërsisë angleze	500	10
Letërsi Maqedonase	60	Magjistër i letërsisë maqedonase	750	5
Letërsi Shqipe	60	Magjistër i letërsisë shqipe	750	10
Metodikë e Gjuhës Angleze	60	Magjistër i metodikës së gjuhës angleze	750	20
Metodikë e Gjuhës Angleze	120	Magjistër i metodikës së gjuhës angleze	500	20
Metodikë e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe	60	Magjistër i metodikës së gjuhës dhe letërsisë shqipe	750	10
Metodikë e Gjuhës Gjermane	60	Magjistër i metodikës së gjuhës gjermane	750	5
Redakturë Gjuhësore	60	Specialist i redakturës gjuhësore	750	15
FAKULTETI JURIDIK	ECTS	Thirrja shkencore	Euro/Semestër	Numri i studentëve
E Drejta Administrative-Kushtetuese	60	Magjistër i së drejtës administrative dhe kushtetuese	750	20



E Drejta Administrative-Kushtetuese *	120	Magjistër i së drejtës administrative dhe kushtetuese	500	20
E Drejta Civile	60	Magjistër i së drejtës civile	750	20
E Drejta Civile *	120	Magjistër i së drejtës civile	500	20
E Drejta Ndërkombëtare	60	Magjistër i së drejtës ndërkombëtare	750	20
E Drejta Penale	60	Magjistër i së drejtës penale	750	20
E Drejta Penale *	120	Magjistër i së drejtës penale	500	20
Gazetari dhe Media *	120	Magjistër i gazetarisë dhe medias	500	20
Gazetari dhe Media *	60	Magjistër i gazetarisë dhe medias	750	20
Kriminalistikë	60	Magjistër i kriminalistikës	750	20
Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci *	120	Magjistër i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci	500	20
Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Europiane *	60	Magjistër i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe studimeve europiane	750	20
Siguri dhe Kriminalistikë *	120	Magjistër i sigurisë dhe kriminalistikës	500	20
FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE	ECTS	Thirrja shkencore	Euro/Semestër	Numri i studentëve
Edukim Fizik	120	Magjistër i edukimit fizik	500	20
Edukim Fizik	60	Magjistër i edukimit fizik	750	20
FAKULTETI I ARTEVE	ECTS	Thirrja shkencore	Euro/Semestër	Numri i studentëve
Dizajn Grafik	60	Magjistër i dizajnit grafik	750	5
Grafikë	60	Magjistër i arteve figurative - Grafikë	750	3
Pikturë	60	Magjistër i arteve figurative - Pikturë	750	5
Skulpturë	60	Magjistër i arteve figurative - Skulpturë	750	3
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE	ECTS	Thirrja shkencore	Euro/Semestër	Numri i studentëve
Biologji - Biokimi	60	Magjistër i biologjisë - biokimist	750	20
Biologji - Botanikë	60	Magjistër i biologjisë - botanikës	750	10
Biologji - Zoologji	60	Magjistër i biologjisë - zoologjisë	750	10
Ekologji	60	Magjistër i ekologjisë	750	10
Fizikë Arsimore	60	Magjistër i fizikës arsimore	750	10



Fizikë Arsimore	120	Magjistër i fizikës arsimore	500	20
Fizikë e Materialeve *	60	Magjistër i fizikës së materialeve	750	10
Fizikë Mjekësore	60	Magjistër i shkencave të fizikës - Fizikë Mjekësore	750	10
Fizikë Teorike *	60	Magjistër i fizikës teorike	750	10
Gjeografi	60	Magjistër i gjeografisë	750	10
Informatikë Arsimore *	60	Magjistër i informatikës arsimore	750	30
Informatikë Arsimore *	120	Magjistër i informatikës arsimore	500	30
Kimi	60	Magjistër i kimisë	750	20
Kimi Arsimore	60	Magjistër i kimisë arsimore	750	20
Kimi Arsimore	120	Magjistër i kimisë arsimore	500	20
Kimi e Mjedisit	60	Magjistër i kimisë së mjedisit	750	20
Matematikë *	60	Magjistër i matematikës	750	20
Matematikë Arsimore *	120	Magjistër i matematikës arsimore	500	20
Matematikë Arsimore *	60	Magjistër i matematikës arsimore	750	20
Shkenca e Materialeve	60	Magjistër i shkencës së materialeve	750	10
Shkenca e të Dhënave *	60	Magjistër i shkencave të të dhënave	750	30
Shkenca Kompjuterike *	120	Magjistër i shkencave kompjuterike	500	30
Shkenca Kompjuterike *	60	Magjistër i shkencave kompjuterike	750	30
FAKULTETI I SHKENCAVE TË ZBATUARA	ECTS	Thirrja shkencore	Euro/Semestër	Numri i studentëve
Arkitekturë	60	Magjistër i shkencave në arkitekturë	750	30
Arkitekturë	120	Magjistër i shkencave në arkitekturë	500	30
Inxhinieria e Komunikacionit-Transportit	60	Magjistër i shkencave teknike në inxhinierinë e komunikacionit-transportit	750	20
Mekatronikë	60	Magjistër i shkencave teknike në mekatronikë	750	20
Mekatronikë	120	Magjistër i shkencave teknike në mekatronikë	500	20
Ndërtimtari	60	Magjistër i shkencave teknike në ndërtimtari	750	25
Ndërtimtari	120	Magjistër i shkencave teknike në ndërtimtari	500	25



FAKULTETI EKONOMIK	ECTS	Thirrja shkencore	Euro/Semestër	Numri i studentëve
Financa dhe Kontabilitet	120	Magjistër i financave dhe kontabilitetit	500	25
Financa, Banka dhe Sigurime	60	Magjistër i financave, bankave dhe sigurime	750	25
Kontabilitet dhe Auditim	60	Magjistër i kontabilitetit dhe auditimit	750	25
Marketing	60	Magjistër i marketingut	750	25
Marketing dhe Menaxhment	120	Magjistër i marketingut dhe menaxhmentit	500	25
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	60	Magjistër i menaxhimit të burimeve njerëzore	750	25
Menaxhment	60	Magjistër i menaxhmentit	750	25
Turizëm	60	Magjistër i turizmit	750	25
FAKULTETI I ADMINISTRATËS SË BIZNESIT - KUMANOVË	ECTS	Thirrja shkencore	Euro/Semestër	Numri i studentëve
Administratë Publike	60	Magjistër i administratës publike	750	20
Administrim Biznesi	60	Magjistër i administrim biznesit	750	20
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE	ECTS	Thirrja shkencore	Euro/Semestër	Numri i studentëve
Infermier/e i/e përgjithshëm - studime specialistike për instrumentarium	60	Infermier/e i/e përgjithshëm - Specialist i instrumentariumit	750	20
Infermier/e i/e përgjithshëm - studime specialistike për kujdes familjar dhe patronazh	60	Infermier/e i/e përgjithshëm - Specialist i kujdesit familjar dhe patronazhit	750	20
Infermier/e i/e përgjithshëm - studime specialistike për kujdes intensiv	60	Infermier/e i/e përgjithshëm - Specialist i kujdesit intensiv	750	20
Infermier/e i/e përgjithshëm - studime specialistike për shëndet mental	60	Infermier/e i/e përgjithshëm - Specialist i shëndetit mental	750	20
Teknik laborant mjekësor - studime specialistike për laborator biokimike	60	Teknik laborant mjekësor - Specialist i laboratorisë biokimike	750	20
FAKULTETI PEDAGOGJIK	ECTS	Thirrja shkencore	Euro/Semestër	Numri i studentëve
Arsim Inkluziv	60	Magjistër i arsimit inkluziv	750	40
Arsimi Elementar	60	Magjistër i arsimit elementar	750	40



Autizmi dhe Aftësia e Kufizuar Intelektuale	60	Magjistër i autizmit dhe aftësisë së kufizuar intelektuale	750	40
Edukim Parashkollor	60	Magjistër i edukimit parashkollor	750	40
Logopedi dhe Dëmtime në Dëgjim	60	Magjistër i logopedisë dhe dëmtime në dëgjim	750	40
Logopedi dhe Dëmtime në Dëgjim	120	Magjistër i logopedisë dhe dëmtime në dëgjim	750	40
Menaxhimi në Arsimit	60	Magjistër i menaxhimit të arsimit	750	40
Pedagogji	60	Magjistër i pedagogjisë	750	40
Pedagogji Sociale	60	Magjistër i pedagogjisë sociale	750	40
Pedagogji Sociale	120	Magjistër i pedagogjisë sociale	500	40
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE DHE TË USHQYERIT	ECTS	Thirrja shkencore	Euro/Semestër	Numri i studentëve
Nutricioni *	120	Magjistër i nutricionit	500	30
Teknologji Ushqimore *	120	Magjistër i teknologjisë ushqimore	500	30
FAKULTETI FILOZOFIK	ECTS	Thirrja shkencore	Euro/Semestër	Numri i studentëve
Filozofi Bashkëkohore	60	Magjistër i filozofisë bashkëkohore	750	10
Filozofi Bashkëkohore	120	Magjistër i filozofisë bashkëkohore	500	15
Gjuhë dhe Letërsi Arabe	60	Magjistër i gjuhës dhe letërsi arabe	750	20
Gjuhë dhe Letërsi Turke	60	Magjistër i gjuhës dhe letërsi turke	750	20
Histori Bashkëkohore	60	Magjistër i historisë bashkëkohore	750	10
Histori e Kohës së Re	60	Magjistër i historisë së kohës së re	750	10
Histori e Mesjetës	60	Magjistër i historisë së mesjetës	750	10
Kultura dhe Religjioni	60	Magjistër i kulturës dhe religjionit	750	20
Psikologji Arsimore dhe Edukative	60	Magjistër i psikologjisë arsimore dhe edukative	750	30
Psikologji Arsimore dhe Edukative	120	Magjistër i psikologjisë arsimore dhe edukative	750	30
Psikologji e Këshillimit me Psikoterapi	60	Magjistër i psikologjisë së këshillimit me psikoterapi	750	20
Psikologji e Këshillimit me Psikoterapi	120	Magjistër i psikologjisë së këshillimit me psikoterapi	500	20
Psikologji Klinike dhe Këshilluese	60	Magjistër i psikologjisë klinike dhe këshilluese	750	30



Psikologji Klinike dhe Këshilluese	120	Magjistër i psikologjisë klinike dhe këshilluese	500	30
Psikologji Organizative dhe Zhvillimi i Karrierës	60	Magjistër i psikologjisë organizative dhe zhvillimit të karrierës	750	30
Psikologji Organizative dhe Zhvillimi i Karrierës	120	Magjistër i psikologjisë organizative dhe zhvillimit të karrierës	500	30
Psikologji Sociale	60	Magjistër i psikologjisë sociale	750	25
Psikologji Sociale	120	Magjistër i psikologjisë sociale	500	25
Sociologji	120	Magjistër i sociologjisë	500	20
Sociologji	60	Magjistër i sociologjisë	750	20
			Gjithsej	2286

** 60 ECTS - studime njëvjeçare, 120 ECTS - studime dyvjeçare

* Program studimor në proces të akreditimit

II. Kushtet dhe kriteret për konkurrim:

a) Të drejtë për konkurrim kanë kandidatët që i plotësojnë këto kushte të përgjithshme:

- Studimet e ciklit të dytë janë vazhdimësi e studimeve themelore;
- Në programet studimore të ciklit të dytë mund të regjistrohet personi i cili ka mbaruar programe studimore përkatëse të ciklit të parë dhe i cili i plotëson të gjitha kushtet të cilat parashihen me Ligjin për arsim të lartë, Statutin e Universitetit dhe me Rregulloren e studimeve të ciklit të dytë;
- Në ciklin e dytë të studimeve akademike universitare me kohëzgjatje prej 1 (një) viti ose dy semestrave, respektivisht 60 kredi, mund të regjistrohen kandidatët të cilët kanë të kryer ciklin e parë të studimeve përkatëse në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetësh, respektivisht 240 ECTS kredi;
- Në ciklin e dytë të studimeve akademike universitare me kohëzgjatje prej 2 (dy) vjetëve ose katër semestrave, respektivisht 120 ECTS kredi, mund të regjistrohen kandidatët të cilët kanë të kryer ciklin e parë të studimeve përkatëse në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjetëve, respektivisht 180 ECTS kredi;
- Në ciklin e dytë të studimeve universitare të specializimit profesional me kohëzgjatje prej 1 (një) viti ose dy semestra, respektivisht 60 ECTS kredi, mund të regjistrohen kandidatët të cilët kanë të kryer ciklin e parë të studimeve përkatëse në kohëzgjatje prej 3 vjetësh, respektivisht 180 ECTS kredi;
- Kandidatët që kanë përfunduar studimet profesionale mund të regjistrohen në ciklin e dytë të studimeve akademike universitare, për të cilin mund të parashikohen provime diferenciale për programin e studimit në të cilin dëshirojnë të regjistrohen;
- Universiteti dhe njësitë e tij përcaktojnë se cilat studime janë të përshtatshme për regjistrim në programe të veçanta studimore të ciklit të dytë, si dhe kushtet për regjistrimin e kandidatëve të cilët kanë kryer programe të tjera studimore nga programi në të cilin aplikohet.
- Regjistrimi në program të ndryshëm nga programi në të cilin studenti ka diplomuar, mund të bëhet sipas kushteve dhe kriterëve që i cakton programi studimor dhe Komisioni i fakultetit për regjistrim gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, varësisht natyrës së programit studimor.
- Përshtatshmëria e ciklit të parë të studimeve universitare për regjistrim në ciklin e dytë të studimeve universitare, si dhe kushtet plotësuese për regjistrim në studimet e ciklit të dytë, përcaktohen me aktin e njësisë akademike i cili i organizon studimet me propozim të programit studimor.

b) Shtetas të huaj:

Shtetasit e huaj kanë të drejtë regjistrimi në studimet e ciklit të dytë në mënyrë të njëjtë si edhe shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

c) Procedura e seleksionimit:

- Të drejtën e regjistrimit, në vitin e parë në studimet e ciklit të dytë, kandidati e fiton në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë Konkurs sipas pikëve të fituara në procesin e seleksionimit;



- Në kushte të barabarta, përparësi gjatë regjistrimit kanë kandidatët me notë më të lartë mesatare nga suksesi i arritur gjatë studimeve, kohëzgjatja e përvojës së punës për kandidatët e paraqitur për studime me korrespondencë dhe punimet shkencore të botuara;
- Komisioni për Konkurs i fakultetit, në tabelat e shpalljeve të fakultetit e shpall rangimin, nga rezultatet e arritura në ciklin e parë të studimeve universitare;
- Pas shpalljes së ranglistës preliminare të kandidatëve për regjistrim nga Komisioni për Konkurs i fakultetit, kandidati ka të drejtë për kundërshtim në afat prej 8 orëve përmes Arkivit ose formës online. Ankesën kandidati ia parashtron Komisionit për Konkurs të fakultetit i cili e shpall listën preliminare. Në të kundërtën, e humb të drejtën për kundërshtim në procedurën e mëtejme të ankesave për rezultatet e shpallura;
- Komisioni për Konkurs i fakultetit ka për obligim të sjellë vendim në afat prej 16 orëve, nga momenti i skadimit të afatit për parashtrim të ankesave;
- Në rast se kandidati nuk është i kënaqur me vendimin e nga ana e Komisionit për Konkurs të fakultetit, në afat prej 24 orësh nga dita e shpalljes së vendimit të Komisionit, kandidati ka të drejtë të parashtrojë ankesë deri te Komisioni Universitar për Konkurs. Vendimi i Komisionit Universitar për Konkurs është përfundimtar;
- Pas skadimit të afatit për parashtrimin e kundërshtimeve dhe shqyrtimit të tyre, Komisioni për Konkurs i fakultetit shpall Aktvendim për pranimin e studentëve (**Ranglista përfundimtare**), në bazë të së cilës bëhet regjistrimi i studentëve. Kandidatët e pranuar si dhe ata të cilët nuk janë pranuar, pas shpalljes së Aktvendimit të Komisionit Universitar për Konkurs, nuk kanë të drejtë kundërshtimi ose ankesë;
- Kandidatët të cilët në afatin kohor të paraparë për regjistrim nuk e bëjnë regjistrimin, respektivisht nuk dorëzojnë dokumentacionin e duhur për regjistrim (Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim) ose fare nuk paraqiten në shërbimet studentore në fakultetin në të cilin janë pranuar, do të konsiderohen se kanë hequr dorë nga regjistrimi.

d) Studime të rregullta dhe me korrespondencë:

- Studenti në studimet e ciklit II mund të regjistrohet si student i rregullt dhe me korrespondencë;
- Programi i studimeve të rregullta u dedikohet studentëve që kanë mundësi t'i ndjekin rregullisht mësimet;
- Fakultetet mund të organizojnë studime me korrespondencë nëse e lejon programi studimor dhe lënda studimore. Studentë me korrespondencë janë ata studentë të cilët programin studimor e ndjekin pjesërisht (përveç punës apo aktiviteteve tjera të cilat kanë nevojë për program specifik);
- Rregullat e studimit si dhe detyrimet e studentit me korrespondencë janë të njëjta me ato të studentëve të rregullt (regjistrimi dhe vërtetimi i semestrit, vijimi në ligjërata, ushtrime, punë laboratorike, përgatitja e punimeve seminarike, puna praktike etj);
- Fakultetet e përcaktojnë formën e organizimit të aktiviteteve mësimore dhe vëllimin e ngarkesës në mësim për studentët me korrespondencë dhe studentët të cilët janë të kyçur në programin mësimor në distancë;
- Programi i studimeve me korrespondencë është i dedikuar për personat e punësuar, për shkak të detyrave të punës, ose për personat, të cilët për shkaqe të ndryshme nuk kanë mundësi t'i ndjekin mësimet e rregullta. Për shkak të karakterit të studimeve, kohëzgjatja e programit të studimeve me korrespondencë është më e gjatë se e studimeve të rregullta, por nuk duhet të jetë më e gjatë se dy vite akademike;
- Kohëzgjatjen e programit të studimeve me korrespondencë e përcakton bartësi i programit studimor të fakultetit përkatës, në varësi të mundësive të studentëve me korrespondencë për ndjekjen e mësimi.

III. Shpenzimet për studimet e rregullta dhe me korrespondencë në studimet e ciklit e dytë i mban vetë studenti me vetëfinansim të studimeve, sipas shumës së përcaktuar me pikën I të këtij Konkursi, si taksë shkollimi. Për punimin e temës së magjistraturës, studentët paguajnë 500 euro, mjete të tjera plotësuese. Mjetet për punimin e magjistraturës, respektivisht specializimit, i paguajnë para mbrojtjes së punimit të magjistraturës, respektivisht të specializimit dhe detyrime tjera financiare të përcaktuara me Vendim dhe Rregulloren e ciklit të dytë. Këshilli i Rektoratit do të sjellë vendim për numrin minimal të nevojshëm të studentëve për fillimin e procesit mësimor në programin studimor përkatës.



IV. Afatet për paraqitje dhe regjistrim

REALIZIMI I KONKURSIT PËR REGJISTRIM TË STUDENTËVE 2026/27	Afati
Aplikimi - dorëzimi i dokumenteve në administratë	7 shtator - 12 tetor 2026
Shpallja e rezultateve preliminare	14 tetor 2026
Shpallja e vendimit për pranim të kandidatëve	16 tetor 2026
Regjistrimi i kandidatëve	19 tetor - 26 tetor 2026

V. Dokumentet e nevojshme për aplikim dhe regjistrim

1. Kandidatët e plotësojnë formularin online në ueb faqen: www.apply.unite.edu.mk. Pas aplikimit në sistemin elektronik, kandidatët duhet që dokumentet t'i dorëzojnë në administratë brenda afatit të caktuar:

A. Pas aplikimit on-line, në emailin e tyre kandidatët pranojnë konfirmim dhe link për aktivizimin e profilit të aplikuesit, prej ku i përcjellin të gjitha fazat e shqyrtimit të dokumenteve, rangimit, rezultateve dhe regjistrimit;

B. Profili i aplikimit mund përdoret edhe për aplikim në afatin e dytë;

2. Gjatë plotësimit të formularit, kandidatët dokumentet më poshtë duhet t'i bashkangjesin (attach) të skenuara ose si fotografi (skenimi ose fotografitë duhet të jenë të lexueshme dhe ta përfshijnë dokumentin e plotë me të gjitha të dhënat);

B. Dorëzimi i dokumenteve bëhet brenda datave të lartëshënuara:

- **Certifikatë nga libri amzë i të lindurve dhe certifikatë shtetësie;**
- **Diplomë e noterizuar për kryerjen e arsimit sipëror** (diploma origjinale dorëzohet vetëm për verifikim gjatë aplikimit);
- **Certifikatë për provimet e dhëna (origjinale);**
- **Kandidatët me arsim të lartë të mbaruar jashtë RMV-së, duhet ta realizojnë procedurën e nostrifikimit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës së RMV-së;**
 - **Kandidatët me shkollim jashtë RMV-së me sistem notimi të ndryshëm duhet të dorëzojnë dokument për ekuivalentimin e notave të lëshuar nga MASH i Maqedonisë së Veriut ,**
- **Dëshmi për akreditimin e programit nga universiteti për shkollimin paraprak (për studentë të cilët studimet nuk i kanë kryer në Universitetin e Tetovës);**
- **Rekomandime nga profesorë ose punonjës shkencorë (nëse i posedon ato);**
- **Vërtetim për përvojë në punë dhe për llojin e detyrave të cilat i ka ushtruar gjatë punës, si dhe kërkesë nga organizata e punës - institucioni, për regjistrim të studimeve pasdiplomike;**
- **Listë të punimeve shkencore ose profesionale dhe kopje nga të njëjtat (nëse kandidatët kanë të tilla);**
- **Dëshmi për çmime të fituara, mirënjohje dhe të ngjashme, si dhe dokumente të tjera (nëse të tilla janë paraparë me aktet e institucionit përkatës).**
- **Vërtetim për pagesë të:**
1050 denarë në xhirollogarinë e Universitetit në emër të taksave administrative.

Kandidatët të cilët janë të pranuar (**pas shpalljes së listës përfundimtare**), regjistrimin e semestrit të parë e realizojnë përmes kyçjes në profilin elektronik të aplikimit, duke shtypur REGJISTRO SEMESTRIN dhe më pas në administratë duhet të dorëzojnë:

1. Fletëparaqitje për regjistrim (Fletëparaqitja lëshohet nga administrata duke e shkarkuar nga sistemi elektronik);

2. Tri fotografi (dy fotografi 6x9cm dhe një fotografi 4x5cm)

3. Vërtetim për pagesën e mjeteve:

- **1200 denarë**, në xhirollogarinë e Universitetit në emër të dhënies së Index-it.
- **Pagesën e mjeteve për semestrin e parë.**

Të gjitha pagesat e lartpërmendura do të kryhen në xhirollogarinë e Universitetit, në këtë mënyrë:

Pagesa prej Maqedonisë së Veriut online: <https://epay.unite.edu.mk/> ose

- Pagesat mund të bëhen edhe përmes aplikacioneve elektronike bankare me formular **PP50** ose me fletëpagesë në bankë/postë;
- Fletëpagesa qoftë përmes aplikacionit ose fletëpagesës në bankë, duhet të figurojë në **emër të studentit;**
- ❖ në emri i marrësit (**назив на примачот**) - Universiteti i Tetovës,



- ❖ në „banka e marrësit” (**банка на примач**) - Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- ❖ në „llogaria” (**сметка**) – **100000000063095**,
- ❖ në „shuma” (**износ**) – shuma e mjeteve financiare që duhet të paguhet,
- ❖ në „llogaria e shfrytëzuesit buxhetor - subjekti shfrytëzues” (**сметка на буџетски корисник – единка корисник**) – **1600160054 788 10**;
- ❖ në „shifra dhe programi i të hyrave” (**приходна шифра и програма**) – **723019 43**, ndërsa në „mënyra” (начин) – **2**;
- ❖ në rubrikën qëllimi i realizimit të pagesës (**цел на дознака**) – qëllimi i pagesës (aplikim, semestri, indeks, provim pranues).
- ❖ Në rast se pagesat përmes aplikacioneve bankare i kryen person tjetër për studentin e caktuar, në këtë rubrikë (**цел на дознака**) - qëllimi i pagesës), e shënon edhe emrin e studentit për të cilin e kryen pagesën (shembull: aplikim Emri dhe Mbiemri)

Pagesa prej jashtë shtetit: <https://epay.unite.edu.mk/>
NATIONAL BANK OF THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA
NAME: UNIVERZITET VO TETOVO
IBAN: MK07 1007 0100 0066 227
SWIFT BIC: NBRM MK 2X
<http://www.unite.edu.mk>,

Tetovë / Korrik, 2026